



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 37, datë 27.01.2021

**MBI VERIFIKIMIN E FIGURËS, PASURISË DHE PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE
TË PARASHIKUARA NGA LIGJI PËR SHËRBIMIN CIVIL PËR KANCELAREN NË
DETYRË NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ELBASAN,
ZNJ. ALKETA KURMAKU**

Bazuar në germën “e”, të pikës 1, të nenit 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në germën “d”, të pikës 1, të nenit 1, dhe pikën 1 dhe 2, të nenit 76, dhe në nenin 111, të Ligjit Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në germën “e” të nenit 21, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pasi u njoh me Raportin me rezultatet “Mbi verifikimin e figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil, për znj. Alketa Kurmaku, kancelare në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për znj. Alketa Kurmaku.
2. Të miratojë raportin me rezultatet e verifikimit të figurës, pasurisë dhe plotësimin të kushteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për znj. Alketa Kurmaku, kancelare në detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
3. Të konfirmojë marrëdhënien civile ekzistuese për znj. Alketa Kurmaku.
4. Të njoftohet për këtë vendim znj. Alketa Kurmaku, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKAJ**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**